



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 9621 Prot.

Fier më 22.08.2025

Projekt - Vendim

Nr. 77 Dt. 22.08.2025

“Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Veko” sh.p.k. për dhënien e të drejtës së kalimit “Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore së transmetimit të energjisë elektrike” në pronat e Bashkisë Fier”

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më datë ____ .08.2025, i paraqitet për shqyrtim materiali i përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Pronave, bazuar në kërkesën zyrtare nr. 10372 prot, datë 11.10.2024 të paraqitur nga shoqëria “Veko” sh.p.k, shoqëri e cila ka lidhur me Ministrinë e Infstrukturës dhe Energjisë Kontraten Nr. 3144 Rep. Nr. 864 Kol. datë 30.11.2022 “Për Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Centralit Gjenerues të Energjisë Elektrike Fotovoltaike, me Kapacitet Prodhues 2 MW dhe Veprave Ndihmëse në zk. 1451 në fshatin Darëzezë Njësia Administrative Dërmënas, Bashkia Fier”.

Bazuar në nenin 9, pika 1.2, nenin 54, shkronja “e, e/1” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (të ndryshuar), Ligjin Nr. 8744, date 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, ligji nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, VKM Nr. 854, datë 04.12.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Dërmënas, të Qarkut Fier”, VKM 510 dt. 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në Njësitë e Qeverisjes Vendore, të prekura nga riorganizimi administrative – territorial”, VKM Nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të Personelit dhe të Aseteve të luajtshme e të Paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”, Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr. 131 dt. 26.11.2024 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2025”; Ligji nr. 68 datë 27.04.2017, “Për Financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, « Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë «Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit»,
Kryetari i Bashkisë:

Propozon:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Veko” sh.p.k. për dhënien e të drejtës së kalimit “Për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjës nëntokësore të transmetimit të energjisë elektrike” në pasuritë nr. 241

(rrugë), nr.243 (kanal), nr. 249 (rrugë), nr. 422 (rrugë), nr. 64/376 (rrugë), zk. 1451, prona të Bashkisë Fier.

2. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Fier për nënshkrimin e akt marrëveshjes dhe çdo dokument të nevojshëm në dobi të qëllimit të saj.

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave

Drejtori: A. Behari

Drejtoria Juridike

Drejtoreshë: E. Kapllanaj

Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit

Drejtoreshë: P. Çina

KRYETARI

Armando SUBASHI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËNKRYETARE**

Suela PRIFTI

